



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1388 Prot.

Tiranë, më datë 15.09.2021

VENDIM
Nr. 573, datë 15.09.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 793, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kritereve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.09.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së subjektit “*GENER 2*” sh.p.k. për pajisjen me licencë si person juridik, në veprimtari arkeologjike dhe veprimtari arkeologjike nënujore, me drejtues teknik z. Dhimitër Çondi, në kategoritë:
 - a) A. Për veprimtarinë arkeologjike:
 - A1. Vëzhgim arkeologjik (*Survey*);
 - A2. Sondazhe arkeologjike;
 - A3. Gërmime arkeologjike.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

